

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr.9776, datë 12.7.2007

PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003
"PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 21 shtohet pika 21/1 me këtë përmbajtje:
"21/1 "Linjat tregtare të interkonjeksionit" janë linjat e reja elektrike të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, ndërmjet dy sistemeve kombëtare elektrike, si dhe të nënstacioneve të invertimit, të ndërtuara me nismën dhe kapitalin e palëve të treta.
Në raste të veçanta, linja tregtare të interkonjeksionit janë dhe linjat e reja të interkonjeksionit, me rrymë alternative, kur kostoja dhe risku i investimit janë shumë të lartë në krahasim me koston dhe riskun, që investitori merr përsipër në ndërtimin e linjave të interkonjeksionit, me rrymë alternative, ndërmjet dy sistemeve fqinje."

Neni 2

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 31/1

1. Ndërtimi i linjave tregtare të interkonjeksionit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) ndërtimi i linjës nuk cenon qëndrueshmërinë dhe sigurinë e operimit të sistemit elektroenergjetik kombëtar;
- b) linja tregtare e interkonjeksionit është në pronësi të një subjekti, person ligjërisht i ndarë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- c) të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe lidhjen e linjës me sistemin e transmetimit përballohen nga vetë investitori;
- ç) asnjë pjesë e kostove, kapitale dhe operacionale, të linjës tregtare të interkonjeksionit nuk përfshihet në koston e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;
- d) investitori bie dakord që 20 për qind e kapacitetit të linjës tregtare të interkonjeksionit të shfrytëzohet për përdorim publik nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

2. Këshilli i Ministrave, përpara miratimit të linjave tregtare të interkonjeksionit, merr mendimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. Afati i shfrytëzimit të linjës tregtare të interkonjeksionit nga investitori është 20 vjet. Pas mbarimit të këtij afati, asetet kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.
4. Operimi i linjave tregtare të interkonjeksionit bëhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, sipas dispozitave të kodit të funksionimit të rrjetit dhe rregullave të tregut.
5. Mirëmbajtja e linjave tregtare të interkonjeksionit është përgjegjësi e investitorit privat gjatë gjithë kohës që ai ka në pronësi këtë linjë.
6. Kapaciteti i linjës së interkonjeksionit, që shfrytëzohet për interes publik, sipas shkronjës "d" të pikës 1 të këtij neni, shpërndalet në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE."

Neni 3

Në nenin 41, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:
"d) operimi i linjave tregtare të interkonjeksionit."

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë kriteret dhe procedurat e zbatimit dhe të miratimit të ndërtimit të një linje tregtare interkonjeksioni.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr.9777, datë 16.7.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN VJETOR RAJONAL CARDS 2006 TË ASISTENCËS KOMUNITARE, PËR AUTORITETET TATIMORE DHE DOGANORE TË BALLKANIT PERËNDIMOR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin vjetor rajonal CARDS 2006 të asistencës komunitare, për autoritetet tatimore dhe doganore të Ballkanit Perëndimor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Fatos Beja